

Trajnimi EUREMnext është parashikuar të nisë në datë **12 Tetor 2018** dhe do të mbahet çdo dy fundjava: të Premte pasdite (16:00 - 20:00) dhe të Shtunë (09:00 - 15:00 max).

Mësimi do të kryhet në ambjentet e **Hotel Opera**, Tiranë.

Gjatë secilës orë mësimore pjesëmarrësit do të marrin materialet e përbëra nga prezantime, pjesë teorike, shembuj praktik në formë elektronike dhe dorazi.

Kurrikula prej **19 modulesh** do të zhvillohet gjatë harkut kohot **Tetor 2018 - Qershor 2019**, në përfundim të së cilës do të kryhet testi përfundimtar dhe prezantimi i Konceptit energjistik.

Për të mbyllur me sukses trajnimin dhe certifikuar si Menaxher Evropian i Energjisë është e nevojshme prania në të paktën **80% të orëve** mësimore ballë për ballë si edhe kalimi në test dhe prezantimin e konceptit në më shumë se **60% të pikëve** totale.



## Austrian Institute of Excellence

Rruga e Dibrës, Kompleksi Halili,

Nd. 64, H. 6, Ap. 37

1017, Tiranë, Shqipëri

E-mail: [projects@aie.al](mailto:projects@aie.al)

Web: [www.aie.al](http://www.aie.al)

Web: [www.energymanager.eu](http://www.energymanager.eu)



# AUSTRIAN INSTITUTE OF EXCELLENCE

Partneri juaj në trajnim, kualifikim dhe certifikim sjell për herë të parë në Shqipëri **EUREMnext!!!**

EUROPEAN ENERGY MANAGER

TRAINING | NETWORK | EFFICIENCY



This project is funded by the European Union



## MODULET EUREM

Bazat shkencore	Teknologjitë e matjeve dhe kontrollit
Ligjet dhe tregtimi i energjisë	Efiçenca e energjisë
Menaxhim Projekti	Sistemet e menaxhimit të energjisë
Fotovoltaikët	Ndërtesat
Biomasa, Biogazi dhe energjia gjeotermike	Ajri i kompresuar; Ajri i kondicionuar
Energjia termike diellore	Motorrët elektrikë
Teknologjia e informacionit "e gjelbër"	Ndriçimi
Proceset e ngrohjes	Teknologjitë e nxehjes
Bashkëprodhimi	Teknologjitë e ftohjes

## ÇFARË ËSHTË EUREM?

EUREM është një program ambicioz trajnimi i standardizuar dhe një rrjet i suksesshëm për "European EnergyManager", i cili tashmë ofrohet në më shumë se 27 vende në të gjithë botën.

Objektivi strategjik kryesor i projektit EUREMnext është të kontribuojë si në mbrojtjen e mjedisit ashtu edhe për konkurrencën në biznes duke rritur cilësinë e auditimeve energjetike dhe kështu edhe shkallën e zbatimit të masave të efiçencës së energjisë. Shumë kompanive do t'ju krijohet mundësia të identifikojnë masat e duhura të energjisë, (psh efiçenca energjetike por edhe integrimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë) në proceset e tyre në mënyrë që të marrin vendime të informuara përgjatë zbatimit.



TRAJNIMI European EnergyManager EUREM është një trajnim i standardizuar për specializim i cili i rrit aftësitë e ekspertëve teknikë në fushën e përmirësimit të efiçencës së energjisë.

Trajnimi zakonisht konsiderohet si specializim extra-profesional dhe përbëhet nga sesione ku prezenca është e domosdoshme, një projekt pune përfundimtar, si dhe nëpërmjet vetëstudimit të materialeve në rrjet.

Për herë të parë në Shqipëri, EUREMnext vjen i financuar nga Bashkimi Evropian dhe mundësuar nga Austrian Institute of Excellence ([www.aie.at](http://www.aie.at)).

Instituti Austriak i Ekselencës shpk është një ofrues lokal trajnimesh me vendndodhje në Tiranë, Shqipëri dhe me një degë në Kosovë, partner lokal i WIFI International me fokus në trajnimin dhe formimin profesional, fuqizimin e shoqërisë civile, mbështetjen e SME-ve, mbështetur në moton "Dije për gjithë jetën".

Ne kemi një përvojë shumëvjeçare në ofrimin e programeve të trajnimit të personalizuara për klientët dhe certifikimit të personelit në fushën e soft-skills dhe atë teknike në përputhje me kërkesat e EN ISO / IEC 17024 duke u fokusuar në mbështetjen e tregut shqiptar dhe kosovar me mjetet e nevojshme për të konkurruar në tregjet përkatëse, si dhe në BE dhe në nivel botëror; duke numëruar më shumë se 3000 pjesëmarrës gjatë dy viteve të fundit.